

20100310548

L I G J
PËR NGARKIMIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË ME HUA NË BANKËN
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM–BANKËN BOTËRORE
SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA PËR HUAN E PARË PËR POLITIKËN
ZHVILLIMORE - DPL 1

Neni 1

Republika e Maqedonisë ngarkohet në Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Bankën Botërore, me hua në shumë prej 20 500 000 eurosh, të dedikuar për realizimin e Huas së parë për politikën zhvillimore-DPL 1.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshjen për hua për Huan e parë për politikën zhvillimore – DPL 1, që do të lidhet ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Bankës Botërore.

Në emër të Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjen për hua nga paragrafi 1 i këtij neni, do ta nënshkruajë ministri i Financave ose personi i autorizuar nga ai.

Neni 3

Afati i pagesës së huas nga neni 1 i këtij ligji është 25 vite, me grejs periudhë të përfshirë prej tetë vitesh.

Norma e kamatës është LIBOR gjashtëmujor me shtrirje të ndryshueshme (për valutën euro).

Në ditën e tërheqjes së mjeteve të huas, Republika e Maqedonisë do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Bankës Botërore, provizion të njëhershëm në shumë prej 0,25 % nga shuma e huas.

Huaja do të paguhet në 34 këste gjashtëmujore, në çdo 15 mars dhe 15 shtator të vitit. Nga 15 marsi i vitit 2018 deri më 15 mars të vitit 2034, do të paguhet 33 këste gjashtëmujore, secili në shumë prej 2,94 % të shumës së huas, ndërsa më 15 shtator 2034, do të paguhet kësti i fundit në shumë prej 2,98% të shumës së huas.

Neni 4

Shfrytëzues i mjeteve të huas nga neni 1 i këtij ligji, është Ministria e Financave.

Neni 5

Republika e Maqedonisë, huan nga neni 1 i këtij ligji, do të paguajë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e botimit në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.